

**RREGULLORE NR. 2002/4**

**MBI TË ARDHURAT PERSONALE NË KOSOVË**

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimet e dhëna me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Duke marrë parasysh Rregulloren nr. 1999/1 të Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) të datës 25 korrik 1999, të ndryshuar, mbi autorizimet e Administratës së Përkohshme në Kosovë, Rregulloren e UNMIK-ut nr. 1999/16 të datës 6 nëntor 1999, të ndryshuar, mbi themelimin e Autoritetit Qendror Fiskal dhe çështjet lidhur me të si dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/20 të datës 12 prill 2000 mbi Procedurat dhe administratën tatimore,

Duke marrë parasysh autoritetin përfundimtar të Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm sipas paragrafit 8.1 (c) të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 15 maj 2001 mbi Kornizën Kushtetuese të Vetëqeverisjes së Përkohshme në Kosovë për t'i përcaktuar parametrat e politikës financiare të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, dhe fakti se insitucionet e përkohshme të vetëqeverisjes ende nuk janë themeluar plotësisht dhe nuk janë në gjendje që të ofrojnë këshilla përmes Këshillit ekonomik dhe fiskal për çështjet që i përfshinë kjo Rregullore,

Me qëllim të caktimit të tatimit në të ardhurat personale në paga si një hap i parë drejt tatimit gjithëpërfshirës në të ardhura personale që mbulon të gjitha burimet e të ardhurave,

Me këtë Rregullore shpall sa vijon:

Neni 1  
Përkufizimet

“Punonjës” do të thotë individ, banor ose jo i Kosovës, i cili fiton të ardhura nga rroga në lidhje me punësimin në Kosovë dhe përfshin zyrtarët qeveritarë e nëpunësit si dhe drejtorët e kompanive.

“Punëdhënës” do të thotë person i cili paguan rrogën drejtrëpërdrejt apo me anë të një personi tjetër për një punonjës ose për shërbimet e kryera në lidhje me punësimin në Kosovë dhe përfshin:

- (a) Çdo njësi qeveritare;
- (b) Çdo organizatë të biznesit qoftë ajo kompani apo ortakëri;

- (c) Çdo organizatë të biznesit e cila punon me mjete në pronësi publike apo shoqërore;
- (d) Çdo organizatë të përhershme të një jorezidenti;

(e) Një organizatë joqeveritare të regjistruar në UNMIK sipas Rregullores së UNMIK-ut nr. 1999/22 të 15 nëntorit 1999 mbi Regjistrimin dhe punën e organizatave joqeveritare në Kosovë;

(f) Një organizatë ndërkombëtare, nëpunësit e ndërlidhjes dhe misionet diplomatike të qeverive të jashtme dhe

(g) Një individ, i cili paguan rroga gjatë kryerjes së një biznesi në Kosovë.

“Organizatë e përhershme” do të thotë vend pune përmes të cilit një jorezident kryen biznesin e tij në Kosovë. Kjo përfshin zyrat e filialave, zyrat e përfaqësive, fabrikat, punëtoritë dhe kantieret e ndërtimit, por nuk kufizohet vetëm me këto.

“Person” do të thotë person fizik ose juridik.

“Punëdhënës kryesor” do të thotë punëdhënës i përcaktuar si i tillë nga punonjësi në kohën dhe në mënyrën e përcaktuar me një udhëzim administrativ që do të lëshohet nga Autoriteti Qendror Fiskal. Individu mund të ketë vetëm një punëdhënës kryesor në një kohë të caktuar.

“Banor” do të ketë kuptimet e mëposhtme:

- (a) Individu është banor në Kosovë:
  - (i) nëse ka vendbanimin kryesor në Kosovë dhe
  - (ii) nëse është fizikisht prezent në Kosovë brenda 183 ditëve apo më shumë gjatë çfarëdo periudhe të tatimit.
- (b) Një kompani ose ortakëri është rezidente në Kosovë nëse:
  - (i) është themeluar në Kosovë dhe
  - (ii) ka vendin e saj të menaxhimit efektiv në Kosovë.

“Tatimpagues” do të thotë individ, i cili fiton të ardhura të tatueshme në Kosovë gjatë periudhës së tatimit.

“Peridhë e tatimit” do të thotë vit kalendarik.

“Pagë” do të thotë çdo shumë e paguar nga punëdhënësi në të holla të gatshme ose në mall si kompenzim për shërbimin e kryer nga një punonjës gjatë kohës së punësimit, me ose pa kontratë të punësimit. Pagat përfshijnë rrogat, pagesat shtojcë, kompenzimin e rrogave, provizionin dhe çdo formë tjetër të pagesës në lidhje me punësimin.

Neni 2  
Të ardhurat e tatueshme

Të ardhura të tatueshme janë të ardhurat e përgjithshme të tatimpaguesit gjatë periudhës tatimore të hequra nga zbritjet e lejueshme sipas kësaj Rregulloreje.

Neni 3  
Të ardhurat e përgjithshme

3.1 Në të ardhurat e përgjithshme, sipas kësaj Rregulloreje, përfshihen të gjitha të ardhurat e pranuar ose të grumbulluara në formë të rrogave gjatë periudhës tatimore, pos të ardhurat e përjashtuara sipas nenit 4.

3.2 Të ardhurat e përgjithshme nga rroga përfshijnë, por nuk kufizohen me to, si më poshtë:

- (a) Pagat e paguara në emër të një punëdhënësi për punën të cilën punonjësi e kryen sipas udhëheqjes së drejtorit;
- (b) Kompnzimi i rrogave, provizionet dhe format e tjera të kompenzimit që një punëdhënës apo ndonjë person tjetër, në emër të punëdhënësit, ua paguan punonjësve mbi dhe përtej rrogës;
- (c) Të ardhurat e fituara me kontrata për punën e përkohshme;
- (d) Pensionet dhe të ardhurat e tjera qoftë të paguara nga punëdhënësi i përparshëm apo nga qeveria;
- (e) Të ardhurat nga punëdhësi i mundshëm, siç është nënshkrimi i një kompnzimi të rrogës;
- (f) Premitë e sigurimit që një punëdhënës paguan për punonjësin;
- (g) Falja e huasë së punonjësit ose e obligimit të punëdhënësit dhe
- (h) Pos nëse përcaktohet ndryshe me këtë Rregullore, përfitimet në mallra që një punëdhënës ia jep punonjësit që kalon shumën minimale të përcaktuar me një udhëzim administrativ që do të lëshohet nga Autoriteti Qendror Fiskal.

3.3 Të ardhurat e përgjithshme nga rrogat nuk përfshijnë:

- (a) Kontributet mandatore nga punëdhënësi për planin e financuar pensional të miratuar nga autoriteti kompetent qeveritar;
- (b) Rimbursimin e shpenzimeve reale të udhëtimeve të biznesit në pajtim me rregullat e saktësuara me një udhëzim administrativ që duhet të lëshohet nga Autoriteti Qendror Fiskal;
- (c) Sigurimin për aksidentet në punë;

(d) Rimbursimin ose kompenzimin për trajtimin mjekësor dhe shpenzimet, duke përfshirë edhe hospitalizimin dhe mjekimin, të pagueshëm sipas sigurimit shëndetësor ose të të paafëtisë në pajtim me ligjin në fuqi, pos rrogat e paguara gjatë periudhës së mungesës nga puna për shkak të sëmundjes ose lëndimit dhe

(e) Përfitimet në mall të dhëna nga punëdhënësi për punonjësit e huaj për të përlehtësuar jetesën e tyre në Kosovë (siç është banimi, mësimi shkollor).

#### Neni 4

##### Të ardhurat e përjashtuara

4.1 Sipas kësaj Rregulloreje, nga tatimi përjashtohen të ardhurat e mëposhtme:

(a) Rrogat e marra nga përfaqësuesit e huaj diplomatik e konsular dhe personeli i jashtëm i Zyrave të Ndërlidhjes në Kosovë, siç është përcaktuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/42 të datës 10 qershor 2000 mbi themelimin dhe funksionimin e Zyrave të Ndërlidhjes në Kosovë;

(b) Rrogat e pranuar nga përfaqësuesit e jashtëm, zyrtarët e jashtëm dhe punonjësit e jashtëm të organizatave ndërkombëtare qeveritare dhe organizatave joqeveritare ndërkombëtare me status të përfitimit publik;

(c) Rrogat e pranuar nga përfaqësuesit e jashtëm, zyrtarët e jashtëm dhe punonjësit e jashtëm të agjencive donatore, të kontraktorëve të tyre apo fondacioneve që realizojnë ndihmën humanitare, punën e rindërtimit, administratën civile a ndihmën teknike në Kosovë;

(d) Rrogat e marra nga zyrtarët e jashtëm dhe zyrtarët e punësuar vendorë të Kombeve të Bashkuara, Agjencitë e saj të specializuara dhe Agjencia Nërkombëtare për Energji Atomike, të cilat sipas kësaj Rregulloreje do të përfshihen në personelin e huaj dhe vendor të UNMIK-ut, siç saktësohet në Rregulloren nr. 2000/47 të datës 18 gusht të vitit 2000 mbi Statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it e të UNMIK-ut dhe personelit të tyre në Kosovë dhe

(e) Rrogat e marra nga personeli i jashtëm i KFOR-it.

#### Neni 5

##### Zbritjet

Kontributet mandatore nga punonjësit për planet e pensioneve të financuara të miratuara nga autoriteti qeveritar kompetent do të lejohen si zbritje nga të ardhurat e përgjithshme.

#### Neni 6

##### Shkallët e tatimit në të ardhura

6.1 Për vitin tatimor 2002 tatimi në të ardhura do të zbatohet në të ardhurat e tatueshme sipas shkallëve të mëposhtme duke filluar prej 1 prillit të vitit 2002:

- (a) Për të ardhurat e tatueshme deri në 600 euro, në shkallë prej zero për qind (0%);
- (b) Për të ardhurat e tatueshme midis 600 dhe 3000 euro, në shkallë prej 5 për qind (5%) dhe
- (c) Për të ardhurat e tatueshme mbi 3000 euro, 120 euro plus 10 për qind (10%) të shumës mbi 3000 euro;

6.2 Për periudhën tatimore të vitit 2003 dhe vitet e pastajme, tatimi në të ardhura do të zbatohet mbi të ardhurat e tatueshme sipas shkallëve të mëposhtme:

- (a) Për të ardhurat e tatueshme deri në 600 euro në shkallë prej zero për qind (0%);
- (b) Për të ardhurat e tatueshme midis 601 dhe 3000 euro në shkallë prej dhjetë për qind (10 %) dhe
- (c) Për të ardhurat e tatueshme mbi 3000 euro, 240 euro plus njëzet për qind (20 %) të shumës mbi 3000 euro.

#### Neni 7

##### Mospagimi i tatimit dhe certifikata e mospagimit

7.1 Secili punëdhënës është përgjegjës për mospagimin e tatimit nga të ardhurat e përgjithshme të rrogave të punonjësve të tij gjatë secilës periudhë të listës së pagave;

7.2 Punëdhënësi i cili është punëdhës kryesor i punonjësit nuk paguan një shumë për periudhën përkatëse të listës së pagave, në pajtim me tabelat e mospagimit, të parashtruara në udhëzimin administrativ që do të lëshohet nga Autoriteti Qendror Fiskal.

7.3 Në tabelat e zbritjes do të përpunohet një tatim i përkohshëm bazuar në pagat e parashikuara të grumbulluara që duhet të paguhet nga punëdhënësi kryesor gjatë vitit, duke reduktuar këtë tatim të përkohshëm me shumën e sasisë së papaguar nga punëdhënësi kryesor për periudhat e përparme të listës së rrogave gjatë vitit.

7.4 Punëdhënësi i cili nuk është punëdhënës kryesor i punonjësit nuk paguan një shumë të barabartë me 10 për qind të rrogave për periudhën tatimore të vitit 2002 dhe 20 për qind të rrogave për periudhën tatimore të vitit 2003 dhe vitet e ardhshme.

7.5 Secili punëdhënës duhet të sigurojë deri më 1 mars të vitit pauses të periudhës tatimore certifikatën e mospagimit për secilin punonjës prej rrogave të të cilëve nuk janë paguar tatimet gjatë periudhës tatimore. Certifikata e mospagimit do të ketë formë të tillë, e cila do të saktësohet në një udhëzim administrativ që duhet të lëshohet nga Autoriteti Qendror Fiskal dhe do të përmbajë informacionin për rrogat e paguara dhe mospagimin e taksës lidhur me punonjësin përkatës.

#### Neni 8

##### Obligimi i mbajtjes së shënimeve

Çdo punëdhënës për secilin punonjës duhet të mbajë përlllogaritjet për tatimin e papaguar dhe do të mbajë librat dhe shënimet që do të saktësohen me një udhëzim administrativ që do të lëshohet nga Autoriteti Qendror Fiskal.

Neni 9  
Deklarimi i tatimit dhe pagesa

9.1 Secili punëdhës duhet të dorëzojë deklaratën për mospagimin e tatimit dhe të paguajë shumën korrekte të tatimit të mospaguar në Administratën Tatimore brenda pesëmbëdhjetë (15) ditësh pas ditës së fundit të secilit muaj kalendarik në pajtim me formën dhe procedurën e cila do të saktësohet në një udhëzim administrativ që do të lëshohet nga Autoriteti Qendror Fiskal.

9.2 Secili punëdhës duhet të dorëzojë një deklaratë vjetore të rekapitulimit tatimor në Administratën tatimore brenda tridhjetë (30) ditësh nga përfundimi i periudhës tatimore me informacionin lidhur me rrogat e paguara dhe taksën e mospaguar e të hequr për secilin punonjës në pajtim me formën dhe procedurën e cila do të specifikohet në një udhëzim administrativ që duhet të lëshohet nga Autoriteti Qendror Fiskal.

9.3 Secili tatimpagues, pos tatimpaguesve për të cilët vlen neni 9.4, duhet të dorëzojë deklarin e tatimit më së voni më 1 prill të vitit pauses të periudhës tatimore, duke deklaruar të ardhurat e tij a të saj të tatueshme si dhe shumën e tatimit të paguar gjatë periudhës tatimore në pajtim me formën dhe procedurën e cila do të specifikohet në një udhëzim administrativ që duhet të lëshohet nga Autoriteti Qendror Fiskal.

9.4 Nga tatimpaguesi nuk do të kërkohet ta dorëzojë deklaratën e tatimit sipas nenit 9.3 kur punëdhësi i tij ose i saj nuk ka paguar tatimin e plotë të duhur në lidhje me të ardhurat e tatueshme dhe kur tatimi i mëtejme ose refundimi është i obliguar.

9.5 Nëse tatimi i mospaguar nga rrogat e tatimpaguesit lidhur me periudhën tatimore është më i vogël sesa tatimi i obliguar në pajtim me nenin 6, tatimpaguesi, në kohën e protokolimit të deklaratës së tatimit, sipas nenit 9.3 duhet të paguajë dallimin midis tatimit dhe tatimit të papaguar.

9.6 Nëse tatimi i papaguar nga rroga e tatimpaguesit është më i madh se tatimi i obliguar në pajtim me nenin 6, tatimpaguesi do të ketë të drejtë për kompenzim për shumën e tejkuqar të papaguar.

9.7 Vendi për dorëzimin e dokumentit të deklaratës së tatimit, pagesës së tatimit dhe ankesës së kompenzimit do të saktësohet në një udhëzim administrativ që duhet të lëshohet nga Autoriteti Qendror Fiskal.

Neni 10  
Inspektimi i të dhënave, i vlerësimeve dhe mbledhja e detyrueshme

10.1 Administrata tatimore, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/20 dhe instrumentet ndihmëse, mund të kërkojë nxjerrjen e dokumenteve apo të informacionit tjetër në lidhje me rrogat dhe tatimin e papaguar nga punonjësit.

10.2 Administrata tatimore, në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/20 dhe instrumentet ndihmëse, mund të lëshojë një njoftim vlerësimi dhe do të kërkojë pagesën nga personat përgjegjës për mospagimin dhe dërgimin e tatimit në Fondin e Konsoliduar nëse ata nuk e dorëzojnë deklaratën ose nuk e bëjnë pagesën korrekte.

10.3 Administrata tatimore mund të përdorë metodat e mbledhjes së detyrueshme për tatimin e autorizuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/20 si dhe instrumentet tjera ndihmëse nëse punëdhënësi ose tatimpaguesi nuk e paguan shumën korrekte të tatimit të obliguar.

10.4 Autorizimet e Administratës tatimore sipas kësaj Rregulloreje nuk vlejnë për punëdhënësit që janë organizata ndërkombëtare qeveritare, misione diplomatike apo zyra ndërlidhjeje të qeverive të jashtme.

#### Neni 11 Shkeljet, dënimet dhe kamata

11.1 Çdo tatimpagues ose punëdhënësi, i cili shkel Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/20 dhe instrumentet tjera ndihmëse, do t'i nënshtrohet dënimeve në fuqi krahas çfarëdo dënimi plotësues dhe kamatës e cila mund të vihet sipas këtij neni.

11.2 Çdo punëdhënësi për mospagim, llogaritje të rrejshme ose për zvoglimin e tatimit të papaguar në paga i nënshtrohet dënimit në shumë prej pesë për qind (5%) të tatimit të papaguar ose të pashlyer për çdo muaj të mospagimit.

11.3 Nëse punëdhënësi nuk e bën pagesën e tatimit nga punonjësi, siç kërkohet me nenin 7 dhe nëse nuk e dërgon shumën e tatimit të papaguar siç kërkohet me nenin 9 ose vonohet me mospagimin apo transferin, kamata do t'i vëhet mbi diferencën midis tatimit që kërkohet për t'u mbajtur dhe të hequr dhe shumës aktualisht të hequr për periudhën e mospagesës, në pajtim me tarifatat komerciale të kredisë në Kosovë të shpallura publikisht herë pas herë nga ana e Administratës tatimore.

11.4 Nëse tatimpaguesi nga i cili kërkohet të dorëzojë deklaratën e tatimit sipas nenit 9.3 nuk e bën këtë apo kur e ka dërguar deklaratën nuk e bën pagesën në pajtim me nenin 9.3, do të ngarkohet me dallimin midis taksës që duhet paguar dhe taksës së papaguar për periudhën e papaguar në pajtim me tarifatat komerciale të kredisë, siç njohtohet herë pas herë publikisht nga ana e Administratës tatimore.

11.5 Dispozitat e këtij neni nuk vlejnë për punëdhënësit që janë organizata ndërkombëtare qeveritare, misione diplomatike apo zyra ndërlidhjeje të qeverive të jashtme.

#### Neni 12 Ankesat

Secili person i goditur drejtëpërdrejt nga vendimi zyrtar i bërë në përputhje me këtë Rregulloreje mund të ankohet ndaj atij vendimi në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2000/20 dhe instrumentet tjera ndihmëse.

#### Neni 13 Ligji në fuqi

Kjo Rregullore shfuqizon secilën dispozitë të ligjit në fuqi që është në kundërshtim me të.

Neni 14  
Zbatimi

Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm mund të lëshojë urdhëresa administrative për zbatimin e kësaj Rregulloreje.

Neni 15  
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi më 1 mars të vitit 2001.

Michael Steiner,  
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm